



Data: 00 qershor 2018

Buletin Informativ

Nr.2, 2018

Drejtori i DVP Kukës, Drejtues Zef LASKA, ftohet në Radio Kukësi, në emisionin "All in One".



Më datë 05.06.2018, Drejtori i DVP Kukës, Drejtues Zef LASKA, u ftua te Radio Kukësi, në emisionin "All in One", për një prezantim me komunitetin e qarkut të Kukësit. Gjatë intervistës, Drejtori i DVP Kukës bëri një prezantim të karrierës së tij policore. Ai ka kryer një sërë detyrash të ndryshme në strukturat e policisë, ku më kryesorët janë: Komandant i Repartit të Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë në Kurbin dhe Tiranë, Shef Komisariati Policie në Kurbin, Specialist për Sigurinë Publike në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Asistent i Zv/drejtorit të Përgjithshëm për Sigurinë Publike, Shef i Sektorit të Analizës së Riskut në Departamentin për Sigurinë Publike në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, Shef i Sektorit të Policimit në Komunitet në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë.

Me pas, Z. Laska renditi disa nga prioritetet kryesore të punës së DVP Kukës:

Zbatimi i masave dhe detyrave të parashikuara në Planin e Veprimit "Forca e ligjit".

Synimi kryesor i punës sonë është goditja e krimit të organizuar dhe trafikeve të paligjshme, duke bashkëpunuar ngushtë edhe me institucionet e tjera ligj zbatuese në Qarkun e Kukësit.

Një prioritet tjetër është rritja e parametrevave të sigurisë publike me qëllim që, të krijojmë një ambient sa më të sigurt për qytetarët e këtij qarku.

Për këtë po riorganizojmë strukturat e policisë, duke bërë një shpërndarje të personelit dhe mjeteve në dispozicion në bazë të një analize të hollësishme të situatës së kriminalitetit dhe faktorëve të tjerë në çdo njësi administrative.

Në kuadër të masave që do të marrim përmendim krijimin e zonave policore, ku në çdo zonë policore do të punojnë së bashku specialistë të hetimit të krimeve, ndihmës specialistë të hetimit të krimeve, oficerë të policimit në komunitet dhe oficerë të patrullës së përgjithshme me qëllim, krijimin e kushteve të përshtatshme që punonjësit e policisë të punojnë në grup për të njohur sa më mirë situatën dhe për të parandaluar dhe dokumentuar veprat penale që mund të ndodhin.

E veçanta e këtij riorganizimi është se punonjësit e policisë në përbërje të çdo zone policore do të kryejnë shërbim në vazhdimësi në të njëjtën zonë, duke i dhënë mundësi punonjësve të policisë të njohin mirë zonën dhe qytetarët, por edhe të njihen nga qytetarët.

Një prioritet tjetër do të jetë parandalimi i kriminalitetit dhe përmirësimi i shërbimit ndaj qytetarëve.

Në fokus të punës sonë do të jetë vlerësimi maksimal i të gjithë ankesave apo kërkesave për ndihmë nga qytetarët, duke ofruar shërbimin policor të nevojshëm brenda një kohe sa më të shpejtë.

Vetëm gjatë 5 muajorit të këtij viti nga strukturat e policisë janë ofruar 525 shërbime të ndryshme të kërkuara nga qytetarët nëpërmjet telefonatave.

Me qëllim ofrimin e një shërbimi sa më profesional qytetarëve, kemi rritur nivelin e përfaqësimit të personelit policor që shërben në sallën e drejtimit të drejtorisë vendore të policisë. Kështu personeli policor që kryen shërbim në këto poste pune do të jenë me gradën policore "Komisar" nga "Nën komisar" që ka qenë deri tani.

Po kështu do të punojmë për trajtimin me profesionalizëm të të gjithë rasteve të konflikteve të ndryshme që evidentohen ndërmjet qytetarëve, duke bashkëpunuar edhe me drejtues të organeve të qeverisjes vendore dhe institucioneve të tjera shtetërore për zgjidhjen ligjore të çdo rasti. Një rëndësi të veçantë do të kushtojmë rritjes së sigurisë në të gjitha shkollat 9 vjeçare dhe të mesme në nivel qarku, duke bashkëpunuar me stafin pedagogjik dhe me drejtuesit e forumeve rinore. Nisur

Botuar nga: Zyra për Komunikimin me Median dhe Publikun në D.V.P. Kukës:

Tel: +355 69 4115009

@kukes@gmail.com



Drejtoria Vendore Policisë kukes

nga fakti se Drejtoria Vendore e Policisë Kukës është përzgjedhur si drejtori pilot, po punojmë së bashku me Programin Suedez për implementimin e filozofisë dhe praktikës së policimit në komunitet, bazuar në përvojën e vendeve të Bashkimit Evropian. Synimi ynë është krijimi i një kulture të re të punonjësve të policisë, nëpërmjet përmirësimit të proceseve të punës, metodave dhe praktikave të policimit, bazuar në filozofinë e policimit në komunitet. Implementimi i këtij modeli policimi do të japë mundësinë strukturave të drejtorisë vendore të policisë dhe komisariateve të policisë që të punojnë në partneritet me institucionet e tjera shtetërore, shoqërinë civile, grupet e interesit dhe komunitetin, për të garantuar rendin publik, duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Parandalimi i aksidenteve rrugore dhe rritja e parametrave të sigurisë rrugore do të jetë një prioritet i rëndësishëm i punës sonë. Siguria rrugore përbën një shqetësim të madh për ne si punonjës policie, por edhe për qytetarët, për shkak të kostove të mëdha njerëzore, materiale dhe financiare që prodhojnë aksidentet rrugore.

Parandalimi dhe goditja e veprimtarisë kriminale të kultivimit të bimëve narkotike do të jetë një prioritet tjetër shumë i rëndësishëm i punës sonë. Është pozitiv fakti që Qarku i Kukësit në raport me qarqet e tjera paraqitet me risk të ulët në lidhje me këtë aktivitet kriminal. Gjatë këtij viti kemi intensifikuar masat për parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike, nëpërmjet një kontrolli të vazhdueshëm të territorit në të gjithë qarkun, si dhe bashkëpunimit me drejtuesit e organeve të qeverisjes vendore, institucione të tjera ligj zbatuese dhe komunitetin. Synimi është që të eliminojmë tërësisht këtë aktivitet të paligjshëm.

Forcimi i integritetit moral dhe profesional të punonjësve të policisë do të jetë një prioritet tjetër i punës sonë.

Për këtë do të punojmë dhe monitorojmë në vijimësi punonjësit e policisë gjatë përmbushjes së detyrave institucionale me qëllim që, ata të sillen me integritet moral dhe profesional.

Do të punojmë që punonjësit e policisë të kërkojnë zbatimin e ligjit me mirësjellje dhe në mënyrë të përshtatshme dhe kurrë të mos përdorin dhunë të panevojshme, si dhe do të luftojmë çdo rast të abuzimit me detyrën.

Zhvillohet takimi "Tryezë e rrumbullakët" e iniciuar nga delegacioni i Ministrisë së Brendshme Britanike, me mbështetjen e Ambasadës Britanike në Shqipëri.



Më datë 13.06.2018, zhvillohet një takim "Tryezë e rrumbullakët" e iniciuar nga delegacioni i Ministrisë së Brendshme Britanike, me mbështetjen e Ambasadës Britanike në Shqipëri. Në këtë takim morën pjesë shefi i Komisarariatit të Policisë Kukës, Komisar Agim Basha, shefi i Seksionit të Policimit në Komunitet në Komisarariatit e Policisë Kukës, Komisar Besnik Braha, Nd/Specialist Zëdhënës KMP dhe asistent në DVP Kukës, Inspektore Diana Deda, oficerë të Patrullës së Përgjithshme dhe SPZ pranë Komisarariatit të Policisë Kukës dhe përfaqësues të Institucioneve të Qarkut Kukës. Tematika e takimit: diskutim Teknik mbi "Qëllimin dhe mënyrat e ndërhyrjes në nivel Komuniteti ndaj të rinjve që rrezikojnë të përfshihen në krimin e rëndë dhe të organizuar", ku u diskutua mbi faktorët dhe rrethanat që i shtojnë të rinjtë të përfshihen në aktivitete kriminale; diskutim mbi një qasje ndër-institucionale dhe se si mund t'i shmangim/redukojmë këto faktorë.

Takim dy ditor me punonjësit e DVP Kukës, organizuar nga qendra "Integrim e Zhvillim Demokratik", Kukës në bashkëpunim me Shoqatën për Kulturë Demokratike dhe Shoqatën Humanitare "Kuka" në ndihmë të Jetimeve dhe të Vobektëve" të Shqipërisë

Më datë 14 dhe 16.06.2018 qendra "Integrim e Zhvillim Demokratik", Kukës në bashkëpunim me Shoqatën për Kulturë Demokratike dhe Shoqatën Humanitare "Kuka" në ndihmë të Jetimeve dhe të të Vobektëve" të Shqipërisë, dega Kukës, zhvilluan një takim dy ditore me punonjësit e Drejtorisë Vendore të Policisë Kukës, me tematikë "Zhvillimi i qasjeve bashkëpunuese duke pasur në epiqendër komunitet në luftë kundër ekstremizmit dhe terrorizmit".

Ky aktivitet kishte si synim:

-Ngritjen e kapaciteteve për parandalimin e terrorizmit dhe radikalizmit në mbrojtje të të drejtave të njeriut.

-Nëpërmjet aktiviteteve gjithë përfshirëse të përsosim marrëdhëniet polici-komunitet.

-Krijimin e një njësi/trupe oficerësh policie për të dialoguar dhe raportuar me gratë, fëmijët dhe shtresat e marginalizuara në luftë kundër ekstremizmit dhe terrorizmit".

